



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LEZHË
KËSHILLI I BASHKISË LEZHË

Nr. 21650 Prot.

Lezhë, më 18 . 12 . 2025

VENDIM

Nr. 117, Datë 15. 12. 2025

PËR MIRATIMIN E VLERËS SË GRANTIT TË MENJËHERSHËM PËR 5 FAMILJET PËRFITUESE TË PROGRAMIT TË SUBVENCIONIT TË INTERESAVE TË KREDISË ME VLERË 1 842 784 LEKË

Në mbështetje të nenit 24 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” i ndryshuar, neni 46 i ligjit nr. 22/2018 “Për Strehimin Social” i ndryshuar, VKM nr. 384, datë 12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfituar sipas programeve sociale të strehimit dhe afateve e procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 555, datë 15.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe përparësitë për akordimin e Grantit të Menjëhershëm për Banesat me Kosto të Ulët nga buxheti i shtetit”, Vendimin Nr. 97 datë 29.08.2022, të këshillit bashkiak “Për miratimin e listës së familjeve që përfitojnë subvencionimin e kredisë për vitin 2022”, vendimin nr. 20790/1 prot., datë 05.12.2025 të Komisionit të Strehimit për “Miratimin e vlerës së grantit të menjëhershëm për 5 familjet përfituese të programit të subvencionit të interesave të kredisë, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit dhe Kujdesit Social, me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli i Bashkisë Lezhë:

VENDOSI:

- I. Të miratojë vlerën e Grantit të Menjëhershëm për 5 familjet përfituese të programit të Subvencionit të Interesave të Kredisë, me vlerë 1 842 784 lekë, nga Buxheti i Shtetit, sipas shtojcës A, bashkëngjitur.
- II. Në zbatim të këtij vendimi, Bashkia Lezhë t’i paraqesë kërkesën Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, për financimin e shumës nga buxheti i shtetit.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Buxhetit.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, të ndryshuar.

SEKRETARI
FLORIDA ÇUNAJ

KRYETARI
NDUE LULI

